

# STATUTI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

## “2AA AGENZIA IMMOBILIARE” SH.P.K

### Kreu I

#### Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

#### Neni 1

#### Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

1.1 Sot, më 15/12/2023, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “2AA AGENZIA IMMOBILIARE” SH.P.K.

1.2 Emri i plotë i shoqërisë është : “2AA AGENZIA IMMOBILIARE ” – Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar.

1.3 Themeluesit e shoqërisë janë :

- Shtetases Shqiptare znj. **Anila Bojko** lindur në Vlorë me 23/02/1982, mbajtëse e kartës së identitetit me nr. personal I25223102C, banues në Rr. “Aleksander Moisiu”, Nd. 29, H.5, Ap.1 Vlorë.

– Shtetasi Italian z. **Andrea Oliviero** lindur në Itali me 14/11/1954, mbajtës i Lejes së Qendrimit me nr. personal F44114002O, banues në Rr. David Selenicasi, 04140076, Nd, 9401, Vlorë

#### Neni 2

#### Objekti

- **Objekti i veprimtarisë** së shoqërisë do të jetë “Ndermjetësim pasurish të patundshme, marrje dhenie me qera apartamente, makina me qera, guida turistike, hoteleri, turizem”
- **shoqëria po ashtu mund të bashkëpunojë me shoqëri të tjera me objekt të njejtë ose të ndryshëm nga i saj.**

#### Neni 3

#### Kohëzgjatja

Shoqëria do të ushtrojë aktivitet për një afat të pacaktuar nga momenti i nënshkrimit të këtij statuti. Ajo do të jetë subjekt i të drejtës shqiptare që nga data e regjistrimit të saj.

#### Neni 4

#### Selia

Selia e shoqërisë “2AA AGENZIA IMMOBILIARE” sh.p.k do të jetë Rr. “Aleksander Moisiu”, Nd. 29, H.5, Ap.1 Vlorë. Shoqëria mund të krijojë agjensi, zyra perfaqesimi, qendra dytesore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.



## Kreu II Kapitali

### Neni 5 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është percaktuar ne masen 100.000,00 Lekë (njqind mije) dhe eshte teresishte kapital financiar I depozituar prej ortakeve themelues.

Kapitali eshte I ndare ne 2 kuota. Pjesëmarrja e ortakeve themelues në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

- 1- Ortaku themelues **Anila Bojko** : Zoterues i 1 (nje) kuote me vlere 50.000,00 (pesedhjete mije Lekë) që përben **50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.**
- 2- Ortaku themelues **Andrea Oliviero**: Zoterues i 1 (nje) kuote me vlere 50.000,00 (pesedhjete mije Leke) që përben **50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.**

Kontributi i ortakëve është në para.

### Neni 6

#### Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

### Neni 7

#### Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

## KREU III ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

### Neni 8 Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.





Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per cheshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" te kesaj pike; dh) mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratorët, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- ë) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) perfaqesimin e shoqerise ne gjykatë dhe ne procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- h) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblesë;
- i) cheshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund te perfaqesohet ne asambленë e pergjithshme, ne baze te një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqerise nuk mund te veprojnë si perfaqesues i ortakeve ne asambленë e pergjithshme.

Autorizimi mund te jepet vetem per një mbledhje te asamblesë se pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njëjtin rend dite.

## Neni 9

### Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet një njoftimi me shkresë ose, nese parashikohet nga statuti, me njoftim nepermjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet te permbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet te gjithë ortakeve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar per mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e pergjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 te këtij neni, ajo mund te marrë vendime te vlefshme vetem nese te gjithë ortakët janë dakord, per te marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

## Neni 10

### Marrja e vendimeve

Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesëmarrës, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumicën e votave te ortakeve pjesëmarrës, per cheshtje te tjera si :

- a) percaktimi i politikave tregtare te shoqerise;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) percaktimin e shperblimeve
- d) mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratorët, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) perfaqesimin e shoqerise ne gjykatë dhe ne procedimet e tjera ndaj administratorëve;



f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;  
Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasyqruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

## **Neni 11 Administrimi**

13.1 Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

13.2 Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

13.3 Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

### **Të dhënat e identifikimit:**

- **Anila Bojko** lindur në Vlore me 23/02/1982,  
banues në Rr. "Aleksander Moisiu", Nd. 29, H.5, Ap.1 Vlore

### **dhe specimenët e nënshkrimit:**

Anila Bojko  


## **Neni 12 Kompetencat e Administratorëve**

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratoret janë të detyruar të therasin Asambleen e Përgjithshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.



Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

#### **Kreu IV Viti financiar**

##### **Neni 13**

##### **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

#### **Kreu V Prishja –riorganizimi i shoqërisë**

##### **Neni 14**

##### **Prishja dhe likuidimi**

Shperndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “ Shoqeri ne likuidim e sipër “.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

##### **Neni 15**

##### **Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

##### **Neni 16**

##### **Baza Ligjore**

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.





Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

**Neni 17**

**Mosmarrëveshjet**


Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptar.

**ORTAKËT**

**E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“ 2AA AGENZIA IMMOBILIARE ”**

  
Anila Bojko

  
Andrea Oliviero

Data : 15/12/2023

Vendi : Vlore